

**RREGULLORE E
KOMISIONIT TË POSAÇËM
TË KOMPENSIMIT PËR TRAJNIM (KPKT)**

PËRKUFIZIME

1. **Kompensimi për trajnim:** Pagesat e kryera në përputhje me Rregulloren e Statusit dhe Transferimit të Lojtarëve për të mbuluar kostot e zhvillimit të lojtarëve të rinj, sipas Nenit 20 “Kompensimi për trajnim”.
2. **Transferim kombëtar:** lëvizja e regjistrimit të një lojtari nga një klub anëtar i Federatës Shqiptare të Futbollit apo pjesëmarrës në aktivitetet e organizuara prej saj, në tjetrin.
3. **KPKT:** Komisioni i Posaçëm të Kompensimit për Trajnim pranë Federatës Shqiptare të Futbollit.

Të gjitha përkufizimet e parashikuara në statutin e FSHF, statutin e FIFA dhe RSTP e FIFA dhe çdo Rregullore tjetër e FSHF janë të vlefshme edhe për këtë rregullore.

Të gjitha termat që u referohen individëve janë të zbatueshme për të dyja gjinitë.

Çdo term në njëjës vlen për shumësin dhe anasjelltas.

KREU I DISPOZITA HYRËSE

Neni 1 Qëllimi

1. Kjo rregullore përcakton rregullat detyruese lidhur me përbërjen, funksionimin, kompetencat dhe procedurën e vendimmarrjes të Komisionit të Posaçëm të Kompensimit për Trajnim (“**KPKT**”) pranë FSHF.
2. KPKT është organi pranë FSHF i ngritur sipas Nenit 5, Pika 6 e Aneksit 1 “Kompensimi për trajnim”, e RRSL që kryen përllogaritjen e shumës së kompensimit për trajnim të lojtarëve, përveç kur është vendosur ndryshe në marrëveshje me shkrim mes klubeve.
3. Kjo rregullore ka për qëllim të përcaktojë mënyrat e përllogaritjes, kushtet dhe afatet e kompensimit për trajnim, në përputhje me Rregulloren e Statusit dhe të Transferimit të Lojtarëve dhe në zbatim të rregulloreve të tjera të FSHF në fuqi.

Neni 2 Parimet e përgjithshme

1. Kjo rregullore do të shërbejë për të mbrojtur disa nga parimet kryesore të sistemit të transferimit të lojtarëve në përputhje me Statutin dhe rregulloret e FSHF, në veçanti.
 - a) të përcaktojë pagesat specifike në lidhje me kompensimin e trajnimit lidhur me transferimin e lojtarëve mes klubeve të futbollit anëtare të FSHF;
 - b) të mbrojë integritetin e sistemit të transferimeve të lojtarëve;
 - c) të përmirësojë dhe promovojë transparencën financiare në sistemin e transferimeve të lojtarëve;
 - d) të parandalojë sjelljet e pandershme në sistemin e transferimeve të lojtarëve.
2. Në funksion të këtyre parimeve, KPKT vepron si organ ndërmjetës për pagesën e kompensimit të trajnimit ndërmjet klubeve, në sistemin e transferimit të lojtarëve për të cilët zbatohet Rregullorja e Statusit dhe Transferimit të Lojtarëve të FSHF.
3. KPKT nuk kryen aktivitet ekonomik dhe nuk realizon asnjë fitim gjatë ushtrimit të aktivitetit sipas kësaj Rregulloreje.

Neni 3 Fusha e Zbatimit

1. Dispozitat e kësaj rregulloreje zbatohen për të gjitha pretendimet dhe kërkesat e paraqitura pranë FSHF nga klubet anëtare të FSHF dhe pjesëmarrësit në veprimtaritë e FSHF që përfshihen në sistemin e transferimeve të FSHF, sipas objektit të kësaj rregulloreje.
2. Çdo kërkesë që është paraqitur për shqyrtim pranë FSHF përpara hyrjes në fuqi të Rregullores së Komisionit të Posaçëm të Kompensimit për Trajnim, do të vlerësohet sipas rregulloreve të mëparshme të FSHF.

3. Kjo rregullore zbatohet për transferimet kombëtare të lojtarëve dhe për të gjitha klubet e anëtarësuara në FSHF.

KREU II KOMISIONI I POSAÇËM I KOMPENSIMIT TË TRAJNIMIT

Neni 4 Qëllimi dhe Përbërja e KPKT

1. Komisioni i Posaçëm të Kompensimit për Trajnim krijohet nga FSHF për të mbikëqyrur dhe vendosur mbi çështjet që lidhen me kompensimin për trajnim për zhvillimin e futbollistëve të rinj.
2. KPKT përbëhet nga 3 anëtarë, një prej të cilëve është kryetari i këtij komisioni. Kryetari dhe anëtarët emërohen dhe shkarkohen nga Komiteti Ekzekutiv i FSHF, për një kohëzgjatje të pacaktuar. Kryetari kryeson mbledhjet e KPKT, siguron respektimin e procedurave dhe përfaqëson KPKT në komunikimet zyrtare.
3. KPKT është përgjegjës për llogaritjen e shumave të kompensimit të trajnimit dhe marrjen e vendimeve për kërkesat për kompensimin e trajnimit të paraqitura nga klubet anëtare të FSHF.

Neni 5 Kompetencat e KPKT

1. KPKT ka kompetencat e mëposhtme:
 - a) Kryen për llogaritjen e kompensimit për trajnim për çdo transferim që i nënshtrohet rregullave të parashikuara nga Neni 20 “Kompensimi për trajnim” dhe Neneve 1 deri 5 te Aneksit 1, te RRSTL.
 - b) Shqyrton kërkesat për kompensimin e trajnimit të paraqitura nga klubet në përputhje me këtë rregullore dhe rregulloret e tjera FSHF.
 - c) Verifikon besueshmërinë e pretendimeve të palëve dhe dokumentacionit mbështetës.
 - d) Dëgjon në seanca dëgjimore palët e përfshira në një pretendim.
 - e) Merr vendim përfundimtar dhe detyruet për masën e kompensimit të trajnimit, ose refuzon kërkesën, bazuar në rregulloret e FSHF në fuqi.

KREU III PROCEDURA E MARRJES SË VENDIMIT DHE PAGESËS SË KOMPENSIMIT TË TRAJNIMIT

Neni 6 Procedura e marrjes së vendimit nga KPKT

1. KPKT do të mblidhet 5 ditë pas çdo periudhe regjistrimi. KPKT do të kryejë vlerësimin e të gjitha transferimeve të kryera nga periudha e mëparshme e transferimit.
2. Komisioni do të verifikojë nëse Klubi (et) ka(në) trajnuar një lojtar që:
 - a. regjistrohet për herë të parë si profesionist dhe
 - b. lojtari profesionist transferohet deri në fund të vitit kalendarik të ditëlindjes së tij të 23-të. KPKT do të marrë vendim mbi masën e kompensimit dhe do t’jua komunikojë palëve.

2. Në rastet kur do të kryhen regjistrime të lojtarëve jashtë periudhës së regjistrimit në një nga rrethanat e parashikuara në Nenin 6, pika 3 e RRSTL, Klubet kanë të drejtë të paraqesin kërkesë me shkrim me objekt kompensim për trajnim drejtuar KPKT.
3. Kërkesa do të shqyrtohet në mbledhjen e Komisionit pas periudhës pasardhëse të regjistrimit.
4. Kërkesa duhet të përfshijë dokumentacionin përkatës që provon trajnimin dhe zhvillimin e lojtarit, duke përfshirë por pa u kufizuar regjistra trajnimi, kontrata, pasaporta e lojtarit, dokumentacionin e regjistrimit dhe transferimit të lojtarit.
5. Pas marrjes së kërkesës për kompensim për trajnim, KPKT shqyrton dokumentacionin e paraqitur për të vlerësuar vlefshmërinë e tij dhe përputhshmërinë me rregulloret e FSHF. KPKT mund të kërkojë informacion, dokumentacion ose sqarime shtesë nga palët e përfshira për të lehtësuar vendimmarrjen e tij.
6. KPKT mblidhet për të diskutuar mbi kërkesën për kompensim për trajnim, duke marrë parasysh të gjitha provat dhe arsyetimet me shkrim dhe gojë e paraqitura nga palët. Komisioni mund të zhvillojë seanca dëgjimore me pjesëmarrjen e palëve si dhe të kërkojë mendime ekspertësh për të arritur një vendim të drejtë dhe të paanshëm.
7. Pas shqyrtimit të kërkesës dhe dokumenteve shoqëruese, KPKT merr vendim me shkrim brenda 30 ditëve kalendarike nga data e mbledhjes me shkrim mbi kërkesën për kompensim për trajnim. Vendimet u komunikohen palëve në rrugë elektronike dhe mund të ankimohen nga palët e përfshira në proces drejtuar DHKZM në përputhje me rregulloret FSHF, brenda 20 ditëve nga marrja vendimit me shkrim nga pala. Ankimi nuk e pezullon ekzekutimin e vendimit.
8. Si kërkesa e palëve, ashtu edhe llogaritja dhe vendimi i KPKT, do të paraqiten në monedhën Lek.

Neni 7

Pagesa e Kompensimit të Trajnimit

1. Klubi që detyrohet të zbatojë vendimin e KPKT duhet të paguajë në rrugë bankare shumën e kompensimit për trajnim në favor të klubit/eve të mëparshme brenda 15 ditëve kalendarike nga data kur KPKT i njofton vendimin me shkrim në përputhje me këtë Rregullore si dhe t'i dërgojë pa vonesa KPKT kopje të dokumentit bankar që vërteton pagesën e kompensimit të trajnimit.
2. Të gjitha komisionet bankare të zbatueshme lidhur me pagesën e kompensimit të trajnimit i ngarkohen klubit që kryen pagesën.
3. Klubet përfituese të kompensimit për trajnim do të paguajnë një tarifë prej 30.000 Lekë, për çdo transferim të shqyrtuar nga Komisioni. Në rast se ka më shumë se një klub përfitues të kompensimit, tarifa do të ndahet *pro rata* midis përfituesve.

Neni 8

Sanksionet

1. Në rast moszbatimi të vendimeve të KPKT, do të zbatohen dispozitat përkatëse të Kodit të Disiplinës dhe Etikës të FSHF, për rastet e mospërbushjes të detyrimeve.
2. Palët pjesëmarrëse në proceset e zhvilluara sipas kësaj rregulloreje, duhet të njoftojnë me shkrim KPKT nëse pretendojnë se vendimet e KPKT nuk janë zbatuar. KPKT, brenda një kohe të

arsyeshme, do të referojë çështjen pranë Komisionit të Disiplinës dhe Etikës për fillim të procedimit disiplinor lidhur me çështjen.

KREU IV DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

Neni 9 Mungesat dhe Precedentët

1. Nëse ka ndonjë mungesë parashikimi në këtë rregullore, KPKT do të marrë vendim në përputhje me parimet e sanksionuara në këtë rregullore si dhe në rregulloret e tjera në fuqi të FSHF, me frymën e përgjithshme të tyre, precedentët e krijuar më parë, dhe në mungesë të tyre, me rregulloret e zbatueshme të FIFA.

Neni 10 Referencat dhe Interpretimi

1. Kjo rregullore zbatohet dhe interpretohet në lidhje të ngushtë dhe në përputhje me parashikimet e rregulloreve të tjera në fuqi të FSHF, më veçanti me Rregulloren e Statusit dhe Transferimit të Lojtarëve.

Neni 11 Çështje te paparashikuara

1. Çështje të posaçme që nuk parashikohen në këtë Rregullore por që kanë lidhje me objektin e saj, do të zgjidhen nga Sekretariati i Përgjithshëm i FSHF. Rastet e forcës madhore do të vendosen nga Komiteti Ekzekutiv i FSHF, vendimet e te cili i të cilit do te jenë përfundimtare.

Neni 12 Mospërputhjet

1. Nëse ndonjë dispozitë e kësaj rregulloreje nuk është në përputhje me statutin e FSHF, apo me Rregulloren e Statusit dhe Transferimit të Lojtarëve, atëherë dispozitat e këtyre të fundit do të prevalojnë.

Neni 13 Dispozita tranzitore

1. Çështjet në lidhje me kompensimin për trajnim, shqyrtimi i të cilave ka nisur përpara DHKZM, do të përfundohen nga kjo e fundit.
2. Kërkesat me objekt: “kompensimin për trajnim” të paraqitura në FSHF dhe të pashqyrtuara deri në datën e hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje, do të merren në shqyrtim nga KPKT, në një sesion të posaçëm jashtë periudhave të transferimit, që do të mblidhet 5 ditë pas hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje dhe miratimit të përbërjes se KPKT.

Neni 14 Hyrja në Fuqi

1. Kjo rregullore u miratua nga Komiteti Ekzekutiv i FSHF në mbledhjen e datës 27.03.2024 dhe hyn në fuqi në po te njëjtën date.